

NJOFTIM PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Titulli : Konsultim publik “Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore 2026 – 2030 në Bashkinë Durrës”.

Propozuesi i projektaktit: Kryetari i Bashkisë.

Qëllimi: Mbledhjen e sugjerimeve të komunitetit lidhur me “Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore 2026 – 2030 në Bashkinë Durrës”.

Kalendari i konsultimit: Konsultimi me komunitetin do të zhvillohet nëpërmjet takimit publik, mbledhjes së sugjerimeve, komenteve dhe rekomandimeve.

Sugjerimet/komentet/rekomandimet janë të mirëpritura deri më datë 5 Qershor 2026, në adresën e emailit:

Daniela.Murataj@durres.gov.al, keshillidurres@gmail.com, diola.xhango@durres.gov.al

Organizues :

- Administrata e Bashkisë Durrës dhe Këshilli Bashkiak

Priten rekomandime/sugjerime nga :

- Banorët e Bashkisë Durrës, pjesëmarrës nga Njësitë Administrative të bashkisë Durrës, anëtarët e shoqërisë civile, anëtarë të biznesit, medias, përfaqësues të komuniteteve fetare në Durrës, grupe të ndryshme interesi apo grupet e marginalizuara, etj.,

Forma e konsultimit: Takim publik dhe postë elektronike.

Qëllimi i këshillimit publik	Konsultimi publik synon përfshirjen e mendimeve, sugjerimeve dhe rekomandimeve të komunitetit lidhur me “Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore 2026 – 2030 në Bashkinë Durrës”. “Barazi gjinore” janë të drejta, përgjegjësi, mundësi, pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjithë diversitetin e tyre, në të gjithat fushat e jetës, si dhe mundësi të barabarta për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëloj nga arritjet dhe zhvillimet e shoqërisë, në respektim të dallimeve biologjike, shoqërore, kulturore, interesave, nevojave dhe prioriteteve të grupeve të ndryshme sipas përkatësisë gjinore; Qëllimi i këtij plani dhe në përputhje me ligjin është: a) të sigurojë të drejtën e çdo individi për barazi gjinore dhe për mbrojtje efektive nga diskriminimi gjinor dhe pabarazitë gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë në jetën publike dhe private, sipas parashikimeve të ligjit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi; b) të përcaktojë për të gjitha fushat e veprimtarisë, përfshirë edhe fushat sipas këtij ligji, masat e përgjithshme dhe të veçanta të bazuara në nevojat dhe prioritetet e
------------------------------	---

	<p>ndryshme gjinore, me qëllim përmirësimin, nxitjen dhe realizimin e barazisë gjinore në shoqëri; c) të përcaktojë autoritetet përgjegjëse për zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri dhe detyrimet e tyre për arritjen e barazisë gjinore, monitorimin dhe vlerësimin e arritjes së saj.</p>
Përshkrimi i çështjes.	<p>Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 64/2025, datë 6.11.2025 “Për barazinë gjinore”, Ligjin 57/2019 10.03.2005 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.121, datë 24.11.2016 , “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror”, Planin Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2023-2025, Komisioni i Barazisë Gjinore ngritur me Urdhërin e Kryetares së Bashkisë ka ushtruar detyrat e tij në hartimin e tij si dhe është përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe raportimit të politikave për barazinë gjinore.</p> <p>Qëllimi është : integrimi i perspektivës gjinore në politikat dhe programet vendore; garantimin e zbatimit të Planit Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore, forcimin e koordinimit ndërsektorial; promovimin e barazisë gjinore në nivel vendor.</p> <p>Vizioni i këtij Plani është : “Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Durrësit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të emigrantëve/emigrantit, të azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.</p>
Kontaktet dhe afatet e dërgimit të komenteve, rekomandimeve, vërejtjeve;	<p>Komentet dhe rekomandimet tuaja jepen në adresën e email-it më poshtë, brenda datës 5 qershor 2026.</p> <p>Daniela.Murataj@durres.gov.al, keshillidurres@gmail.com, diola.xhango@durres.gov.al</p>
Projekt-vendimi, relacioni shoqëruar, në lidhje me çështjen që konsultohet.	<p>Materialet dhe relacionet për konsultimin me publikun mund t’i gjeni në faqen Web të bashkisë, faqja kryesore.</p> <p>https://durres.gov.al/category/bashkia/njoftime/ https://durres.gov.al/konsultimet-publike/</p>
	<p>Pas mbledhjes së rekomandimeve, Administrata e Bashkisë dhe Këshilli i Bashkisë do të ndjekë hapat si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Realizimin nga ana e Sekretariatit të Këshillit në bashkëpunim me KNJKP i një “Përmbledhje të rekomandimeve dhe rezultateve të

<p>Shpjegim të procesit që do ndjekë dhe veprimet që do të ndërmarrë Këshilli për të shqyrtuar rekomandimet nga publiku deri në marrjen e vendimit</p>	<p>plota” që përfshin të gjitha mendimet dhe propozimet që do të vijnë nga komuniteti.</p> <ol style="list-style-type: none"> 2. Dërgimi i kësaj Përmbledhje Rekomandimesh Kryetarit të Bashkisë, Komisionit të Barazisë Gjinore në Bashkinë Durrës, Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, dhe çdo këshilltari të bashkisë; 3. Shqyrtimi nga ana e Komisionit të mësipërm të çdo rekomandimi dhe të opinionit të Kryetarit të Bashkisë; 4. Marrja e vendimit për rekomandimet që do të përfshihen në Planin Vendor të Veprimit për Barazi Gjinore 2026–2030 në Bashkinë Durrës. 5. Diskutimi dhe miratimi i aktit në seancën e hapur të Mbledhjes së Këshillit; 6. Publikimi i aktit në faqen e Këshillit të Bashkisë dhe në tabelat e informimit; 7. Njoftimi i administratës për aktin e miratuar; 8. Monitorimi i zbatimit të tij.
<p>Data e publikimit</p>	<p>11.05.2026</p>